



## KONKURS PËR PUNË

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika (ix), nenit 30, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 i Statutit të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), Bordi i ShKÇAK shpallë:

## K O N K U R S

**Institucioni:** Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK)

**Titulli i vendit të punës:** Drejtor Ekzekutiv

**Kategoria e pozitës:** Drejtuese

**Kohëzgjatja e kontratës:** Katër (4) vite me mundësi të rizgjedhjes

**Raporton:** Bordit të ShKÇAK

### Detyrat dhe përgjegjësitë

- Të punojë me Bordin e Shoqatës në zhvillimin dhe implementimin e biznes planit strategjik afatgjatë si dhe planit vjetor të Shoqatës;
- Të ndërtojë kapacitete organizative të Shoqatës siç përcaktohet nga Bordi i Shoqatës;
- Të mbikëqyrë personelin e Zyrës Ekzekutive;
- Të organizojë programet trajnuese të Shoqatës;
- Të mbajë dhe zhvillojë marrëdhëniet me donatorët ekzistues dhe të mundshëm;
- Të punojë me media që të sigurojë mbulimin e duhur të aktiviteteve të Shoqatës nëpër media;
- Të këshillojë, adoptojë dhe implementojë politikat e veprimit dhe aktivitetet e Shoqatës për arritjen e qëllimeve dhe objektivave;
- Të implementojë rregulloret, aktet tjera normative, vendimet, dhe instrumentet tjera të adoptuara nga Kuvendi i Anëtarëve dhe Bordi i Shoqatës;
- Të implementojë buxhetin e Shoqatës;

- Të përfaqësoj Shoqatën në nivel vendor dhe ndërkombëtarë;
- Të ndërmarr të gjitha aktivitetet për t'i mbështetur në vazhdimësi Qëllimet dhe Objektivat e Shoqatës.

### **Kualifikimet dhe përvoja:**

1. Diplomë universitare në fushën e Menaxhimit, Administrimit të Biznesit apo fusha të ndërlidhura;
2. Preferohet kualifikim pasuniversitar në fusha të ndërlidhura sipas pikës 1;
3. Preferohet të jetë anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK);
4. Minimumi 5 vite përvojë profesionale e dëshmuar në pozita menaxhuese/udhëheqëse;
5. Përvojë e dëshmuar në menaxhimin strategjik, planifikim dhe zbatim të politikave dhe programeve të një organizate;
6. Përvojë e dëshmuar me organizata vendore, ndërkombëtare bashkëpunime ndërinstytucionale apo përfaqësim institucional;
7. Përvojë në zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve si dhe bashkëpunimi me donatorë;
8. Kualifikimet shtesë profesionale, përbëjnë përparësi.

### **Aftësitë dhe kompetencat:**

- Aftësi të shkëlqyera udhëheqëse dhe vizion strategjik për zhvillimin e mëtejshëm të organizatës;
- Njohuri të kornizës ligjore dhe institucionale si dhe të standardeve ndërkombëtare që lidhen me fushën e veprimit të organizatës;
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe përfaqësimi me publikun, mediat dhe partnerët institucionalë;
- Aftësi të shkëlqyera për të ndërtuar dhe ruajtur bashkëpunime efektive me palët e interesit dhe anëtarët;
- Aftësi të shkëlqyera në menaxhimin e ndryshimeve dhe zgjidhjen e problemeve komplekse;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në grup, nën presion dhe me afate kohore.

### **Kërkesat e përgjithshme për punësim:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar me dëshmi institucionale;
- Të mos jetë i/e dënuar për kryerjen e një vepre penale për të cilën ekziston një vendim i formës së prerë.
- Të ketë njohuri të avancuara të gjuhës angleze në të folur dhe shkruar.

Procedura e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar sipas këtij konkursi:

- Shpallja e konkursit do të bëhet në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të ShKÇAK si dhe në portalin KosovaJob;
- Kandidatët duhet të dorëzojnë biografi:
  - ✓ CV në të cilën do të ndërlidhin arritjet e tyre me kërkesat e konkursit;
  - ✓ Letër motivuese ku do të paraqesin vizionin e tyre për udhëheqjen me ShKÇAK për 4 vitet e ardhshme; dhe
  - ✓ Së paku tre referenca – listë me kontaktet e tyre.
- Afati për dorëzimin e aplikacioneve do të jetë i hapur deri me datë **15/05/2025**
- Aplikacionet duhet të dorëzohen përmes E-mail adresës: [hr@scaak.org](mailto:hr@scaak.org), me përshkrim-  
Për pozitën: **DREJTOR EKZEKUTIV**

Aplikimet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit nuk do të pranohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet.